REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 320, Datë 03.11.2026**

**MBI**

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 189, DATË 13.07.2026 "MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "ALBESP TRADING & CONSULTING" SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrik*e"; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*"; si dhe nenit 15, të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 03.11.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1564/11 prot., datë 02.11.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës *"Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 189, datë 13.07.2026 "Mbi rinovimin e licensës së shoqërisë "Albesp Trading & Consulting" sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike",*

**Konstatoi se:**

1. **Të dhëna mbi shoqërinë "ALBESP TRADING & CONSULTING" sh.p.k.**

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 189, datë 13.07.2026, vendosi të rinovojë licencën nr. 492, Seria F21, të shoqërisë "AlbEsp Trading & Consulting" sh.p.k., për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 241, datë 02.12.2021, për një afat 5(pesë)-vjeçar, me efekt nga data 03.12.2026.
- Në pikën 2 të dispozitivit të vendimit nr. 189/2026, shoqërisë i është lënë detyrë që jo më vonë se data 01.11.2026, të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të qirasë për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument në lidhje me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të vlefshmërisë së licencës.

2. **Analiza ligjore dhe vlerësimi**

- Me shkresën nr. 1564/9 prot., datë 22.10.2026, ERE i ka sjellë në vëmendje shoqërisë për të depozituar në ERE brenda afatit sa përcaktuar në pikën 2 të vendimit. Me shkresën e saj nr. 365/1 prot., datë 26.10.2026, protokolluar në ERE me nr 1564/10 prot., datë 27.10.2026, shoqëria ka depozituar kontratën e rinovuar për përdorimin e zyrave përfaqësuese, me afat deri më 01.08.2027.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar rezulton se shoqëria "ALBESP TRADING & CONSULTING" sh.p.k. ka përmbushur, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 189, datë 13.07.2026, detyrimin për depozitimin e kontratës së rinovuar të qirasë për përdorimin e ambienteve ku ushtron veprimtarinë. Kontrata e depozituar ka afat vlefshmërie deri më 01.08.2027, ndërkohë që licenca e rinovuar ka një kohëzgjatje pesëvjeçare, me efekt nga data 03.12.2026. Në këto kushte, me qëllim garantimin e vijimësisë së disponimit të ambienteve të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së licencuar, vlerësohet e arsyeshme riformulimi i detyrimit të përcaktuar në pikën 2 të vendimit nr. 189/2026, duke

parashikuar paraqitjen e dokumentacionit përkatës përpara përfundimit të vlefshmërisë së kontratës aktuale.

**3. Nevoja për ndryshimin e vendimit**

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*", parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë. Në kete kuptim ERE ne cilesine e organit publik që ka nxjerrë një akt administrativ ka kompetencën për ndryshimin e tij, në përputhje me kushtet dhe kufizimet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Në rastin konkret, duke marrë në konsideratë përmbushjen nga shoqëria të detyrimit të përcaktuar në pikën 2 të vendimit nr. 189/2026, si dhe afatin e vlefshmërisë së kontratës së depozituar, vlerësohet e nevojshme riformulimi i kësaj pike, me qëllim përcaktimin e një detyrimi të qartë për dokumentimin e vijimësisë së përdorimit të ambienteve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së licencuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Miratimin e një ndryshimi në vendimin e bordit të ERE-s nr. 189, datë 13.07.2026, si vijon:

   a) *Pika 2 e vendimit, ndryshon dhe bëhet:*

   *2. Shoqëria "AlbEsp Trading & Consulting" sh.p.k., jo më vonë se data 01.08.2027, të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të qirasë për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument në lidhje me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të vlefshmërisë së licencës.*

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë "Albesp Trading & Consulting" sh.p.k., shoqërinë "Operatori i Sistemit të Transmetimit" sh.a., shoqërinë "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a. dhe shoqërinë "ALPEX" sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**